STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 13 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE LIRR DO TE RIVENDOSE SHERBIMIN E KUFIZUAR GJATE DITEVE TE JAVES NE DEGEN E LONG BIÇ (LONG BEACH)

Shërbimi do të funksionojë çdo orë gjatë periudhave të pikut dhe çdo dy orë jashtë pikut, ndërmjet 4:58 të mëngjesit dhe 8:58 të mbrëmjes gjatë ditëve të javës

Shërbimi me lokomotiva me naftë do të funksionojë derisa të mund të rivendoset energjia elektrike në shinën e tretë përgjatë degës

Grafiku i shërbimit është bashkëngjitur

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Hekurudha e Long Ajlënd (LIRR) e MTA-së do të rifillojë shërbimin e kufizuar me tren gjatë ditëve të javës ndërmjet Long Biç (Long Beach) dhe Linbruk (Lynbrook) të mërkurën, 14 nëntor në 5:00 në mëngjes, duke shënuar herën e parë që trenat do të funksionojnë në Qytetin e Long Biç (Long Beach) të goditur rëndë që kur Uragani Sendi (Sandy) ndërpreu energjinë e shinës së tretë në të gjithë degën.

“Hap pas hapi, sistemi i tranzitit i Nju Jorkut po rimëkëmbet nga pasojat katastrofike të Urganit Sendi (Sandy),” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Ky shërbimi i kufizuar në linjën LIRR të Long Biç (Long Beach) do të jetë një ndihmë për udhëtarët dhe për ata që mbështeten në këtë shërbim.”

Duke përdorur trena me naftë që nuk kërkojnë energjinë e shinës së tretë, LIRR do të sigurojë shërbimin e shpejtë në Degën e Long Biç (Long Beach), duke bërë të gjitha ndalesat ndërmjet Long Biç (Long Beach) dhe Linbruk (Lynbrook) - një udhëtim rreth 20 minuta.

“E kuptojmë sesa e rëndësishme është për rimëkëmbjen që të rivendosim njëfarë niveli të shërbimit të trenit për në Qytetin e Long Biç (Long Beach) dhe për komunitetet përgjatë degës që u shkatërruan nga Superstuhia Sendi (Sandy),” tha Presidentja e LIRR-it Helena E. Uilliams (Helena E. Williams). “E dime se njerëzit duhet të shkojnë në punë dhe punëtorët e rimëkëmbjes kanë nevojë të jenë në gjendje që të mbërrijnë në Long Biç (Long Beach) për të ndihmuar në përpjekjen e rimëkëmbjes. Personeli ynë inxhinierik dhe ekipet kanë punuar pa pushim për të gjetur një zgjidhje. Ky shërbim me naftë do të na lejojë të sigurojmë transport përgjatë degës.”

Shërbimi i modifikuar do të funksionojë ndëmjet 4:58 në mëngjes dhe 8:58 në mbrëmje gjatë ditëve të javes.
Trenat do të funksionojnë çdo orë në periudhat e pikut të mëngjesit/mbrëmjes me lidhje të drejtpërdrejta në platformë (vetëm në drejtimin mbizotërues) në Linbruk (Lynbrook) dhe do të funksionojnë çdo dy orë gjatë periudhës jashtë pikut. Gjatë periudhave jashtë pikut, udhëtarët mund të duhet të presin në Linbruk për deri në 15 minuta për shërbimin e lidhjes.

Shërbimi i trenit të degës së Long Biç (Long Beach) nuk do të funksionojë në fundjava ose festa, përfshirë Ditën e Falënderimit (Thanksgiving). Përkundrazi, shërbim me autobus do të sigurohet në secilin stacion ndërmjet Long Biç (Long Beach) dhe Linbruk (Lynbrook).

Pagesat e pikut dhe jashtë pikut të LIRR do të jenë në fuqi për këtë shërbim, por konsumatorëve do t'u kërkohet pagesa e stacionit për blerjen e biletave në tren nga Long Biç (Long Beach) në Centre Avenue. Energjia në disa stacione dhe makina të biletave përgjatë degës vazhdon të mungojë. Pagesat e stacioneve të poshtëm do të kërkohen për udhëtarët që hipin në: Centre Avenue, Ist Rokauej (East Rockaway), Osheansajd (Oceanside), Ajlënd Park (Island Park) dhe Long Biç (Long Beach). Udhëtarët, megjithatë, inkurajohen të blejnë bileta paraprakisht kurdoherë që është e mundur për të shmangur vonesa. LIPA ka rivendosur energjinë në stacionin e LIRR në Long Biç (Long Beach) dhe zyra e biletave do të jetë hapur. Zyra e biletave në Linbruk (Lynbrook) gjithashtu do të jetë e hapur pesë ditë në javë gjatë kësaj emergjence.

Tre nga katër nënstacionet elektrike përgjatë degës së Long Biç (Long Beach) që ushqejnë më elektricitet shinën e tretë u dëmtuan rëndë nga përmbytja. Një nënstacion në kantierin e Long Biç (Long Beach) pësoi dëm si nga uji i detit dhe nga ujrat e zeza që e përmbytën nga një uzinë e trajtimit të ujrave të zeza aty pranë. Çelësat elektrike në kantierin e Long Biç (Long Beach) – kur trenat ruhen dhe u bëhen shërbime – u përmbytën dhe u dëmtuan nga uji i detit. LIRR është duke punuar për të riparuar dëmin. LIRR vlerëson se shërbimi i rregullt mund të mos rifillojë për të paktën tre javë të tjera.

LIRR hapi dhomën e saj të pritjes në Long Biç (Long Beach) më 6 nëntor si një stacion lehtësimi, duke ju lejuar banorëve që të ngrohen, të përdorin mjediset e banjës dhe të përdorin kabllot e energjisë për të karikuar telefonat celularë dhe pajisjet e tjera elektronike. Përveç kësaj, LIRR ka vënë në funksionim një autobus falas përgjatë degës.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

*(Shihni skedarin e bashk*ëngjitur*: LongBeach_TT_EffectiveNov14.pdf)*

Albanian